



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

## NJOFTIM

Në mbledhjen e datës 28 korrik 2026, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe diskutimeve të zhvilluara në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi, mori vendimet që vijojnë:

U miratua fillimi i procedurës administrative për licencimin e shoqërisë “KORPORATA ELEKTROENERGJITIKE SHQIPTARE (SH.A KESH)” sh.a në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga impianti fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 8.25 MW, me vendndodhje në Digën e Zadejës, HEC Vau i Dejës, Qarku Shkodër.

U miratua kërkesa e shoqërisë “DOMA GROUP” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga Hidrocentrali “Vunjolli 1”, me kapacitet të instaluar 1.840 MW, me vendndodhje në përroin e Varrosjit, Manadresë dhe Lajthit, degë e përroit të Zallit të Madh, Bashkia Mat, Qarku Dibër për një periudhë 30-vjeçare. Shoqëria duhet të nisë ushtrimin e veprimtarisë brenda datës 30 prill 2027, të dokumentojë testimin e veprës dhe të përditësojë të dhënat mbi stafin teknik pas fillimit të operimit, si dhe të depozitojë lejen e rinovuar për përdorimin e burimit ujqor brenda afateve të përcaktuara nga vendimi i Bordit.

Në përfundim të shqyrtimit të kërkesës së shoqërisë "GREENSOL" sh.p.k., u miratua licencimi në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike për centralin fotovoltaik me vendndodhje në Njësinë Administrative Mesopotam dhe Bistricë, Bashkia Finiq, Qarku Vlorë, për një kapacitet të instaluar prej 41.29 MW.për një periudhë 25-vjeçare. Shoqëria duhet të përmbushë detyrimet e përcaktuara në vendimin e Bordit lidhur me lidhjen me rrjetin, ndërtimin dhe vënien në operim të centralit, duke filluar ushtrimin e veprimtarisë brenda 19 dhjetorit 2028.

U pranua fillimi i procedurës administrative për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë "HIDROINVEST 1" sh.p.k. për zgjidhjen e mosmarrëveshjes me shoqërinë OSSH sh.a., lidhur me konfigurimin teknik të lidhjeve 35 kV në transformatorin TR-1 të nënstacionit Prrenjas, në përputhje me procedurat e parashikuara në kuadrin rregullator në fuqi

U miratua analiza dhe vlerësimi i Raporteve Vjetore të Pajtueshmërisë për vitin 2025 të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes “OSSH” sh.a. dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit “OST” sh.a. Në përfundim të shqyrtimit të raporteve, u lanë detyrat përkatëse për ndjekjen e gjetjeve dhe zbatimin e rekomandimeve të përcaktuara në raportet përkatëse. Analiza e raporteve evidentoi se gjatë vitit 2025 janë ruajtur pavarësia funksionale, organizative dhe operacionale e operatorëve, si dhe janë zbatuar masa për garantimin e trajtimit jodiskriminues të përdoruesve të rrjetit, mbrojtjen e informacionit të ndjeshëm dhe forcimin e transparencës.

Në të njëjtën kohë, ERE rekomandoi vijimin e masave për përmirësimin e zbatimit të Programeve të Pajtushmërisë, përditësimin e tyre në përputhje me kuadrin e ri ligjor, rritjen e transparencës dhe monitorimin e vazhdueshëm të zbatimit të rekomandimeve, me qëllim garantimin e një tregu të energjisë elektrike të pavarur, transparent dhe konkurrues.

Në këtë mbledhje, Bordi shqyrtoi edhe raportin periodik mbi Garancitë e Origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e rinovueshme, për periudhën maj–qershor 2026.

Raporti evidentoi funksionimin normal të regjistrit elektronik të Garancive të Origjinës, miratimin e aplikimeve të Nova Solar System sh.p.k. dhe KESH sh.a., si dhe realizimin e 7 transferimeve të para të Garancive të Origjinës ndërmjet subjekteve të regjistruara, duke shënuar një hap të rëndësishëm në zhvillimin e këtij tregu në Shqipëri.

Gjatë periudhës së raportimit nuk u refuzua asnjë aplikim, nuk u pezullua asnjë procedurë dhe regjistri funksionoi pa probleme teknike apo operative.

Në datën e raportimit, regjistri elektronik përmban: • 8 llogari aktive të subjekteve dhe llogarinë e ERE-së si autoritet lëshues; • 4 impiante prodhimi të regjistruara; • 481,182 MWh Garanci Origjine të lëshuara, nga të cilat 456,020 MWh aktive, 163,102 MWh të transferuara dhe 25,162 MWh të skaduara.

ERE do të vijojë administrimin dhe përditësimin e regjistrit elektronik të Garancive të Origjinës, në mbështetje të transparencës dhe zhvillimit të tregut të energjisë nga burimet e rinovueshme.

Vendimet e plota publikohen në faqen zyrtare të ERE-s dhe në Fletoren Zyrtare.